



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 41.2 “ç” të Statutit të Komunës, dhe nenin 4.2 të Udhëzimit Administrativ për Organizimin dhe Funkcionimin e Komiteteve Konsultative në Komuna Nr. 2008/10, dhe vendimin e Kuvendit të Komunës **01.Nr. 58/16, dt. 31.03.2016**, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë shpall:

K O N K U R S

Për anëtarësim në këto Komitete Konsultative të KK-së:

1. Komiteti për Arsim, Kulturë, Fe, Sport dhe Rini (7 anëtarë);
2. Komiteti për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike (7 anëtarë);
3. Komiteti për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit (7 anëtarë);
4. Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale (7 anëtarë);
5. Komiteti për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore (7 anëtarë);
6. Komiteti për Personat me Nevoja të Veçanta (7 anëtarë).

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Japin propozime për rregullore të ndryshme sipas lëmive përkatëse.
- Japin mendime dhe ide rreth iniciativave që i ndërmerr kryetari i komunës, komitetet e përhershme, apo kuvendi i komunës në fushat përkatëse.
- Paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve para kryetarit të komunës dhe kuvendit të komunës.
- Paraqesin propozimet për zgjidhjen e problemeve të identifikuara.
- Paraqesin ide apo propozime për hulumtime të ndryshme.

Mandati:

Mandati i parë i anëtarëve të komiteteve konsultative është **trevjeçar** në baza të rregullta. Anëtarët e komiteteve konsultative mund të shërbejnë më së shumti për dy mandate të njëpasnjëshme si anëtarë të këtyre komiteteve.

Kompensimi:

Për punët e tyre në komitetet konsultative, anëtarët e këtyre komiteteve do të kompensohen konform dispozitave të nenit 9 të Udhëzimit Administrativ Nr.16/2008 për Pagesën e Stafit Politik në Komuna.

Kushtet:

Të drejtë për të marrë pjesë në konkurs- për anëtarësim në komitetet konsultative kanë të gjithë qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të Komunës së Vushtrrisë, të cilët duhet të jenë ekspertë, përkatësisht njohës të fushave përkatëse. Njohës i asaj fushe apo anëtar i organizatës e cila merret me atë fushëveprimtari.

Përfaqësimi gjinor në komitetet konsultative duhet të jetë në kuotën e 30 %-shit, duke përfshirë pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në proporcion të përfaqësimit të tyre në komunë.

Kandidati për anëtar në komitetet konsultative duhet të jetë banor i Komunës së Vushtrrisë.

Përgatitja profesionale e kërkuar:

Studime universitare.

Përvoja e punës dhe njohja e punës me kompjuter janë të preferuara.

Dokumentet e kërkuara:

CV;

Diploma;

Ekstrakti i lindjes;

Kopja e letërnjoftimit;

Dëshmia për përvojën e punës.

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet t'i nënshtrohen intervistimit.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit, nuk do të shqyrtohen.

Dorëzimi i dokumenteve të kërkuara mund të bëhet çdo ditë pune prej orës 09:00 deri në orën 15:30 në Zyrën e Pranimet të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova

Kryesuesi i Kuvendit

